

## NË EMËR TE POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik**, si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi , Sek. Juridike Shpresa Hoxha , në qështjen penale të akuzurit [REDAKTUAR] nga Kaçaniku i akuzuar se ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nënpar 1 të KPK-së, sipas Aktakuzës të PK-Ferizaj, PP.Nr. 2349-02/12, të datës 25.04.2013 , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor, oral dhe publik me datën 10.01.2017 në prani të përfaqësuesit të PTH-Ferizaj Agim Kuka, të akuzuarit [REDAKTUAR], muarr dhe shpalli këtë;

### AKT GJYKIM

#### I akuzuari:

[REDAKTUAR] nga Kaçaniku rruga "[REDAKTUAR]" i lindur me [REDAKTUAR] në Kaçanik nga i ati [REDAKTUAR], dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë, [REDAKTUAR], shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri, i denuar edhe më parë NP. [REDAKTUAR]

#### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 14.12.2010, në kohë të përcaktuar në Kaçanik në rrugën "Migjeni", përkatësisht në shtëpinë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, i pandehuri, me përdorimin e forcës e hap derën nga ana e mbrapme të shtëpisë , me ndihmën e një kaçavide, depërton mbrenda dhe nga aty merr një kompjuter dhe një plestejshën të cilat i shet më vonë secilën nga 50 euro në Ferizaj, duke i shkaktuar dëm në vlerë prej 650 € sipas të dëmtuarit,-

Me këtë veprim kreu veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nënpar 1 të KPK-së

Andaj gjykata duke u bazuar me dispozitat e nenit 3, 11, 15, 41, 45,47,,neneve 73,75, të KPK dhe nenit 365 , 453 dhe 463 të KPPK-së e

### GJYKON

Të pandehurit [REDACTED] i shqipton me dënimin me burg në kohëzgjatje prej 30 ditëve i cili dënim me pëlqimin e te akuzuarit , shndërrohet ne dënim me gjobë në shumë prej 450.00 € e cila do të paguhet në tri kiste mujore në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit .

Udhëzohet i dëmtuari që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Obligohet i pandehurit që të paguaj në emër të shpenzimeve procedurale të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 30.00 euro.

## A r s y e t i m

PK nga Ferizaji, me aktakuzën e vet . PP.Nr. 2349-02/12, të datës 25.04.2013 , të akuzuarin [REDACTED] nga Kaçaniku e ka akuzuar për shkak të veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nënpar 1 të KPK-së.

Në shqyrtimin gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka mbeti në tërsi pranë aktit akuzes së paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDACTED] të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe të i shqiptohej denim meritor sipas ligjit . Njiherit i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes së denimit ti ketë parsysh si rrethanat lehtsuese, pendimin e thellë të tij , bashkpunimin me gjykatën-prokurorin për zbardhjen së të vërtetës dhe si rrethanë rënduese faktin se se është vepër e drejtuar kundër pasurisë së peronit tjetër. .

I akuzuari [REDACTED] në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor në tërsi e ka pranuar kryerjen e veprës penale që i veket në barrë sipas aktit akuzues dhe njiherit është penduar i vjen keq për këtë vepër penale, premtion se në të ardhmën nuk do përseritet më dhe propozon që gjykata të ia shqipton një denim sa më të butë.

Pasiqë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale që i veket në barrë dhe është e bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare duke u mbshtetur në nenin 248 të KPPK edhe në faktet dhe provat që përmban akti akuzues por edhe ne shkresat e lendes, ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par 4 të KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqsore e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera dhe pa mbajten e sancës se dytë dhe seancës për shqyrtim gjyqsor.

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarit arë ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nënpar 1 të KPK-së, për të cilën vepër penale i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit

nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin gjyqsor, , kurse për bazë për llojin dhe lartsin e denimit ka marrë parashysh moshën e tij të re , kohen e kaluar nga kryerja e vepërs penale, efekti do arrihet edhe më këtë denim, ndërsa rrethanë rënduese se kjo veper penale është e drejtuar kundrejt pasurisë private dhe është dukuri e shpeshtë.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjësive penale të akuzuarit dhe peshën e vepres penale, kështu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit , do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së dhe atë efektin rehabilitues dhe pengues tek kryersi, efektin preventiv në mjedis si dhe reagimin shoqror ndaj kësaj dukurie negative dhe të ndeshkushme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe mbi udhëzimin e palës të dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuror-juridike në contest civil është i mbshtetur në dispozitët e neneve 453 dhe 463 të, KPPK-së ,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. nr. 174/13 Me dt. 10.01.2017

Sek. Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtari  
Shabi Idrizi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e paktuar ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

